

ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE E SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE PËR VITIN 2016

Departamenti i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI)


Analiza epidemiologjike e sëmundshmërisë infektive për vitin 2016 bazohet në të dhënat e ndryshme të Sistemit të Integruar të Survejancës së Sëmundjeve Infektive (SISSI) të vendit tonë, të raportuara nga Shërbimet e Epidemiologjisë të Rretheve në DEKSI (Departamenti i Epidemiologjisë dhe i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, ISHP).

Të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të SISSI, janë të raportuara përmes pasqyrës mujore 14/Sh.

Gjatë analizës epidemiologjike të sëmundshmërisë infektive për vitin 2016 janë paraqitur një përmbledhje të të gjitha nozologjive të përfshira në pasqyrën 14 sh, ku infeksionet respiratore zënë peshën kryesore specifike në sëmundshmërinë e përgjithshme infektive, të ndjekura nga sëmundjet diarreike.

Sëmundjet diarreike

Gjatë vitit 2016, totali i sëmundjeve diarreike paraqitet me incidence per 100.000 banore eshte 2864,43 (80208 raste). Në frekuencën (numër rastesh) dhe incidencën (raste për 100.000 banorë) vjetore të hasjes së sëmundjeve diarreike gjatë vitit 2016, gastroenteriti i paspecifikuar zë vendin kryesor, ndjekur nga toksikoinfeksionet alimentare, shigeloza dhe salmoneloza jotifoide.



Rrethet me problematike me numrin me te madh te rasteve me salmoneloze jotifioide dhe shigeloze janë Shkodra, Kukësi dhe Tirana. Rrethet me problematike me numrin me te larte te rasteve me toksikoinfeksionet alimentare janë Bulqiza, Berati, Kukësi dhe Tirana.

Sëmundjet infektive qe parandalohen nga vaksinat

Të dhënat e survejancës epidemiologjike mbi frekuencën vjetore (numri i rasteve) dhe nivelet vjetore të incidencës (raste për 100.00 banorë) për secilën nga sëmundjet infektive të cilat parandalohen nga vaksina paraqiten në detaje me poshtë. Sëmundjet infektive të parandalueshme me vaksinim, Programi Kombëtar i Imunizimit, dhe raportohen në pasqyren 14 sh janë: *fruthi, rubeola, parotiti, hepatiti A, Hepatiti B, PFA, varicele, pertusi, difteria, meningiti meningokoksik dhe tetanozi*. Të dhënat për këto sëmundje paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Te suspektuar	Te konfirmuar
Fruth	16	1
Rubeole	2	0
Parotit epidemik	14	3
Hepatiti A	2	22
Hepatiti B	1	71
PFA	8	0
Pertussis	38	5
Difteri	0	0
Varicele	1955	705
Meningit bakterial meningokoksik	0	1
Tetanoz	1	0

Të dhënat mbi fruthin dhe rubeolën bazohen në Survejancën e Bazuar në Rast të Fruthit / Rubeolës (me konfirmim laboratorik të rastit). Në Survejancën e Bazuar në Rast të fruthit për vitin 2016 janë raportuar 17 raste të dyshuara për fruth. Hetimi epidemiologjik është kryer menjëherë me marrjen e njoftimeve dhe, nga të gjithë pacientët janë marrë mostrat e gjakut për ekzaminim virologjik në laboratorin e Virologjisë në ISHP, si dhe është verifikuar vaksinimi i fëmijëve. Ekzaminimi laboratorik ka rezultuar pozitiv për IgM ndaj fruthit vetëm për një rast. cili është infektuar në Francë. Rasti është konfirmuar në ISHP.


Në Survejancën e Bazuar në Rast për rubeole janë raportuar gjatë 2016 vetëm dy raste të suspektuara të cilat pas ekzaminimeve në ISHP kanë rezultuar negative.

Paralizat Flaksidike Akute (PFA)

Të dhënat bazohen në Survejancën e Bazuar në Rast të PFA-ve (me konfirmim laboratorik të rastit). Në Survejancën e Bazuar në Rast të PFA për vitin 2016 janë raportuar 8 raste të cilat janë të suspektuara. Hetimi epidemiologjik është kryer menjëherë me marrjen e njoftimit dhe, nga të gjithë pacientët janë marrë 2 mostra feçe për ekzaminim virologjik në laboratorin e Virologjisë në ISHP, si dhe është verifikuar vaksinimi i fëmijëve. Ekzaminimi laboratorik ka rezultuar negativ për virusin e Poliomielitit. Rastet e suspektuara janë në Fier, Gjirokastrë, Mat, Permet dhe Tiranë.


Hepatitet virale

Hepatitet virale gjatë vitit 2016 sipas pasqyrës 14 Sh, paraqiten me një total prej 277 rastesh (9.89), ku peshën më të madhe specifike e zë hepatiti viral i paspecifikuar 158 (5.64) raste ndjekur nga hepatiti viral B 72 (2.57) raste, hepatiti viral A dhe hepatiti viral as A as B.



Zoonozat

Të dhënat e survejancës epidemiologjike për katër zoonozat e mëposhtme, tregojnë për një frekuencë vjetore të pranishme gjatë vitit 2016 me predominim të brucelozës me një total prej 145 raste (Incidenca 5.17), ndjekur nga leptospiroza përkatësisht me 40 raste (incidence 1.42), antraksi me 34 raste (incidence 1.21), dhe nga një nivel i ulët i hasjes së leishmaniozës viscerale 12 raste dhe leishmanies kutane në vlerën 6 raste.



Sëmundjet infektive Rikeciale

Rikeciozat janë sëmundje infektive, subjekt i raportimit të detyrueshëm në SMBS të survejancës epidemiologjike. Duhet të theksojmë që në grupin e rikeciozave të paspecifikuara është dhe mbizotërimi i rasteve vjetore për sëmundjet rikeciale në vlerën 6 (0.21) raste për vitin 2016.

Sëmundjet infektive me vatra natyrore

Numri i sëmundjeve infektive që përfshihen në këtë grup është shumë i madh por murtaja, ethet e verdha, ethet dengue dhe ato rekurrente epidemike nuk janë hasur në Shqipëri por janë pjesë e raportimit të detyrueshëm në pasqyrën 14-sh. Gjithashtu, duhet theksuar që dhe leshmaniaza, shumica e rikeciozave dhe malaria janë sëmundje infektive me vatra natyrore por janë trajtuar dhe në veçanti.

Rrethet ku është hasur ethja hemorragjike

Siç shihet dhe nga të dhënat e survejancës janë konfirmuar 30 (1.07) raste me ethe hemorragjike virale (Hantan dhe CCHF) gjatë vitit 2016. Nga totali i rasteve, 5 raste janë konfirmuar dhe 25 raste kane qene te suspektuara. Rastet me ethe hemorragjike kanë qenë të rretheve Devoll, Diber, Elbasan, Fier, Gjirokaster, Kolonje, Korce, Kruje, Kukës, Lac, Librazhd, Lushnje, Mat, Tirane dhe Has.

Sëmundjet infektive parazitare

Malaria, Dermatofitozat, Scabies dhe Ankilostomiaza përbëjnë sëmundjet parazitare të raportuara në pasqyrën 14-sh, ku sipas të dhënave të survejancës epidemiologjike lidhur me frekuencën vjetore të hasjes (numri i rasteve të raportuara) dhe nivelet vjetore të incidencës (raste për 100.000 banorë), dermatofitia endemike zë peshën specifike kryesore në vlerën e 704 (25.14) raste, qarkullim ky I vazhdueshëm në popullatën e vendit tonë, e ndjekur nga scabies me 211 (7.53) raste. Në lidhje me numrin total të rasteve të raportuara me malarie, nuk kemi asnjë rast autokton në vendin tonë. Të gjitha rastet 3 (0.10) te suspektuara, janë raste të importuara nga lëvizjet e popullatës në vendet ku malaria qarkullon në mënyrë endemike Dy raste me malarie jane te konfirmuara ne laboratorin e ISHP, dhe jane nga Elbsani dhe Vlora.

